REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 04.11.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.10.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "TSR SHPK"., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sinjalizimi rrugor në Qerim, Piskot, Berkoc, Blloku i ri, Has, reka keqe, reka mirë", Nr. i prokurimit- 632-26-5866-2-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-041-211, nxjerr:

V E N D I M

1. **REFUZOHET SI E PABAZUAR** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "TSR SHPK"., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sinjalizimi rrugor në Qerim, Piskot, Berkoc, Blloku i ri, Has, reka keqe, reka mirë", Nr. i prokurimit- 632-26-5866-2-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-041-211, e paraqitur kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues 09.09.2026 në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **VËRTETOHET** Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i publikuar me datë 22.10.2026;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "TSR SHPK"., me dt.27.10.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Sinjalizimi rrugor në Qerim, Piskot, Berkoc, Blloku i ri, Has, reka keqe, reka mirë", Nr. i prokurimit- 632-26-5866-2-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-041-211.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, më datë 04.11.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe pas shqyrtimit të pretendimeve të parashtruara, ka konstatuar se:

Një pjesë e pretendimeve të ngritura në kërkesën e tanishme për rishqyrtim nuk paraqesin pretendime të reja, por janë në thelb të njëjta me pretendimet e paraqitura edhe më herët nga Operatori Ekonomik ankues dhe të cilat tashmë janë shqyrtuar dhe janë bërë objekt i vlerësimit nga Autoriteti Kontraktues në kuadër të procedurës së mëparshme.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së kërkesës së tanishme rezulton se Operatori Ekonomik ankues nuk ka paraqitur ndonjë fakt, provë apo rrethanë të re thelbësore, të natyrës faktike apo juridike, e cila do të mund të ndryshonte përfundimin e arritur më parë nga Autoriteti Kontraktues.

Përsëritja e të njëjtave pretendime, pa paraqitjen e elementeve të reja faktike ose juridike dhe pa identifikimin e ndonjë rrethane të re që do të ndikonte në ligjshmërinë e veprimit apo vendimit të Autoritetit Kontraktues, nuk mund të shërbejë si bazë për rishqyrtim të pakufizuar të së njëjtës çështje procedurale.

Qëllimi i kërkesës për rishqyrtim është t'i mundësojë operatorit ekonomik kundërshtimin e një veprimi, vendimi ose procedure të Autoritetit Kontraktues mbi bazën e pretendimeve konkrete, të individualizuara dhe të argumentuara, e jo që e njëjta çështje të parashtrohet në mënyrë të përsëritur, pa ndryshim të rrethanave faktike ose juridike.

Megjithatë, duke respektuar të drejtën e Operatorit Ekonomik për mjete juridike dhe me qëllim të sigurimit të një shqyrtimi të plotë të pretendimeve të ngritura, Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar edhe përmbajtjen e kërkesës së tanishme dhe ka konstatuar se pretendimet e ngritura nuk qëndrojnë.

Sa i përket pretendimeve të ankuesit për dokumentacionin shtesë të kërkuar nga operatori ekonomik "TRAFFIKS VA SH.P.K"., Autoriteti Kontraktues vlerëson se këto pretendime janë të pabazuara. Dokumentet e dorëzuara, përkatësisht autorizimi i ZIR për Elektromodul, si dhe dëshmitë për përputhshmërinë me standardet EN të pajisjeve semaforike dhe sinjaleve të tjera ndriçuese, konsiderohen të mjaftueshme për të dëshmuar përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit.

Kërkesa për sqarim është përdorur për të qartësuar dhe verifikuar dokumentacionin dhe karakteristikat e produktit të ofertuar, me qëllim të marrjes së një vendimi të bazuar në një vlerësim të plotë dhe objektiv.

Procedura e sqarimit të ofertave ekziston pikërisht për rastet kur, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit, Autoriteti Kontraktues ka nevojë të marrë sqarime apo dokumentacion mbështetës për të verifikuar përmbajtjen dhe përputhshmërinë e ofertës.

Në rastin konkret, dokumentet e kërkuara përmes B47 nuk kanë ndryshuar çmimin, objektin, specifikimet e ofruara, pozicionet e ofertës apo ndonjë element tjetër ekonomik të saj. Ato janë kërkuar me qëllim të verifikimit të karakteristikave teknike dhe dokumentacionit mbështetës të produktit të ofruar.

Për këto arsye, Autoriteti Kontraktues vlerëson se kërkesa për rishqyrtim duhet të refuzohet si e pabazuar dhe vendimi i mëparshëm i Autoritetit Kontraktues të mbetet në fuqi.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kopje:

Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Të gjitha palëve te interesuara;

FATON GUTAJ

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.